

## 3.2 HIDROIZOLUES DY KOMPONENTËSH

### IZOELASTIC



Njësia matëse	Copë / paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
25 kg/thes 10 kg/bidon	54 copë / paletë 60 copë / paletë	2 - 4kg/m <sup>2</sup>	Komponenti A Komponenti B



#### IZOELASTIC

Material dy komponentësh me bazë çimento dhe hidroizolues, elastik me funksion mbrojtës për tarraca, themele, pishina dhe bodrume.

#### KARAKTERISTIKAT

Hidroizolues dy-komponentësh me bazë çimento, inertesh me granulometri të seleksionuar, aditivësh special dhe polimere sintetike në disperzion ujor. Duke përzier dy komponentët, përfitohet një masë që mund të aplikohet edhe në sipërfaqe vertikale, me një trashësi deri në 1 mm për shtresë. Falë përmbajtjes së lartë të rezinave sintetike dhe cilësive të tyre, ai garanton një ngjitje të shkëlqyer në të gjitha sipërfaqet e betonit, tullave dhe qeramikës (të parapërgatitura). Pas forcimit, ai krijon një shtresë hidroizoluese dhe elastike, rezistente ndaj agjentëve atmosferikë.

#### FUSHA E ZBATIMIT

- Shtrimin e membranave hidroizoluese përpara vendosjes së pllakave për brenda dhe jashtë.
- Mbrojtje fleksibël dhe rezistente ndaj ujit e lagështisë për sipërfaqet e betonit dhe suvatë. Sa më i madh është presionit ujit aq më i trashë duhet aplikuar produkti.
- Veshje hidroizoluese dhe mbrojtëse e sipërfaqeve të betonit, subjekt i agresionit kimik, si kripërat anti-ngricë, sulfatet, etj.
- Nivelim hidroizolues dhe elastik i suvave të plasaritura.
- Veshje hidroizoluese dhe mbrojtëse e mureve në themele.
- I përshtatshëm për hidroizolim të sipërfaqeve të cilat janë subjekt i vibrimeve dhe i deformimeve të ndryshme.
- Hidroizolim i pishinave me beton të maturuar (mbi 6 muaj)

#### MËNYRA E APLIKIMIT

##### Përgatitja e suportit

Dysheme çimentoze në ballkone, tarraca dhe pishina, sipërfaqja që do të izolohet duhet të ketë një pjerrësi të përshtatshme dhe nuk duhet të ketë gropa (gropat duhen të mbulojnë me FIBREN GP - 70). Në qoftë se suporti ka mbetje telash apo hekurash të cilat dalin nga thellësia e betonit apo murit atëherë ato duhen prerë në thellësi 2 - 4 cm dhe më pas gropën e hapur e mbulojmë me mënyrën e përshkruar më lart. Sipërfaqja që do të trajtohet duhet të jetë plotësisht e pastër, rezistuese

dhe e qëndrueshme. Për izolimin e bodrumeve në ndërtesat e vjetra, duhet të hiqet çdo suvatim ekzistues deri në një lartësi prej 30 cm mbi nivelin e lagështisë dhe më pas të vazhdohet si më lart. Në rastin e mbivendosjes së pllakave mbi pllakat ekzistuese të qeramikës, sigurohuni që ato të jenë të ngjitura mirë; pastroni dhe përgatitni sipërfaqen e dyshemesë së vjetër me kujdes, fillimisht me një detërgjent të përshtatshëm, dhe më pas me FUGA CLEAN. Suvatë duhet të jenë të maturuara (7 ditë për çdo cm trashësi) me ngjitje të përshtatshme në suport dhe rezistencë mekanike të mirë. Sipërfaqja që do të trajtohet duhet të jetë plotësisht e pastër dhe e qëndrueshme. Lagni me ujë sipërfaqen që do të izolohet, përpara se të aplikoni IZOELASTIC.

#### APLIKIMI

Derdhni komponentin B (lëngun) në një enë të pastër të përshtatshme; më pas, shtoni me ngadalë komponentin A (pluhurin) duke e përzier mekanikisht. Përziejini me kujdes me një përzierës mekanik me shpejtësi të vogël, derisa të përfitohet një masë homogjene. Nuk këshillohet përgatitja e përzierjes manualisht. APLIKIMI i materialit bëhet me furçë ose me rrul në disa duar në varesi të mbrojtjes që duam të sigurojmë ndaj ujit. Materiali aplikohet 1 mm për shtresë. Shtresa pasardhëse aplikohet mbasi të jetë tharë shtresa paraardhëse. Mbasi të keni aplikuar materialin duhet ta mbronni atë nga temperaturat e larta, shiu, etj. Në këndet lidhëse midis dyshemeve dhe mureve apo në sipërfaqet me shumë shtypje dhe mikroçarje etj, IZOELASTIC ka nevojë për përforsim duke mbuluar sipërfaqet me një shirit rrjetë me fibra 10 cm dhe ngjës sipërfaqja është shumë difektoze atëherë të mbulohet komplet me rrjetë me fibra xhami nga 65 - 125 gr për m<sup>2</sup>. Gjithashtu rrjetë përdoret dhe për pishina apo tarraca.



**TË DHENA TEKNIKE (në 23°C dhe 50% U.R)**

	A	B
Pamja	pluhur	lëng
Ngjyra	Gri/Bardhe	bardhë
Masa volumore	1.5 gr/cm <sup>3</sup>	1.1 gr/cm <sup>3</sup>
Mbetje e thatë	100%	50%
Djegshmëria	I padjegshëm	
Ngjyra e përzierjes	Gri	
Raporti i përzierjes	25	10
Konsistenca e përzierjes	I lyeshëm me furçë	
Koha e punueshmërisë	≥60 min	
Masa volumore e përzierjes	1.7 gr/ cm <sup>3</sup>	
Temperatura e aplikimit	nga+8°C deri në +30°C	
Trashësia max për dorë	1 mm	
Koha midis duarve	4-5 orë	
Koha për shtrimin e pllakave	24 orë	
Afati i ruajtjes	12 muaj	